

Njoftim për konsultimin publik lidhur me projektligjin “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore tek personat fizike dhe juridike të huaj”.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, fton qytetarë, ekspertë të fushës, shoqata dhe përfaqësues të tjerë të publikut të interesuar për të kontribuar përgjatë procesit të konsultimit publik të projektligjit “*Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore tek personat fizike dhe juridike të huaj*”.

Ky projektligji ka për qëllim përshtatjen e kuadrit ligjor mbi tokën bujqësore me pronar shtetin me zhvillimet dinamike ekonomike sot në vendin tonë dhe me fokus të veçantë investimet e huaja. Mungesa e një baze ligjore të qartë dhe të posaçme që lejon kalimin e pronësisë ose të drejtës së përdorimit të tokës bujqësore tek të huajt ka krijuar pengesa të vazhdueshme për investitorët potencialë si edhe pasiguri juridike.

Po kështu, në kuadër të zhvillimeve të procesit të integritit evropian, Shqipëria gjithashtu duhet të përafrojë legjislationin mbi pronësinë e tokës bujqësore me *acquisin* e BE-së, ku parashikohet mundësia e kalimit të pronësisë së tokës bujqësore te personat fizike dhe juridike të huaj kur plotësohen kushtet e vendosura nga ligjvënësi me qëllim garantimin e interesit publik dhe mbrojtjen e burimeve natyrore. Miratimi i këtij projektligji është i nevojshëm për disa arsye kryesore:

- Siguria dhe stabiliteti legjislativ: një kuadër ligjor i qartë dhe i detajuar siguron që procesi i shitblerjes të jetë i rregullt, i kontrolluar dhe i parashikueshëm, duke shmangur keqpërdorjet dhe konfliktet ligjore.

- Mbrojtja e interesave kombëtare dhe ekonomike: Qeveria synon të sigurojë që tokat bujqësore të mbeten mundësi shfrytëzimi për qytetarëve shqiptarë ose të shërbejnë për zhvillimin e qëllimeve ekonomike dhe sociale, duke shmangur privatizimin e tepruar të tokës nga huajt gjë e cila mund të çënojë sovranitetin dhe interesat kombëtare.

- Ruajtja e mjedisit dhe urbanizimi i qëllimshëm: ligji ndihmon në kontrollin e zhvillimit të tokës bujqësore, duke parandaluar shfrytëzimin e padrejtë dhe shkatërrimin e mjedisit natyror.

- Krijimi i një kuadri të qartë për investimet: për huajt që dëshirojnë të investojnë në sektorin bujqësor, një ligj i posaçëm siguron transparencë dhe rregulla të standardizuara, duke rritur besimin dhe sigurimin juridik.

- Parandalimi i spekulimeve dhe abuzimeve: ligji ndihmon në shmangien e keqpërdorjeve të mundshme në procesin e shitblerjes së tokës bujqësore nga ana e huajve, duke siguruar që proceset të kryhen në mënyrë të ligjshme dhe të ndershme.

Në përgjithësi, ligji është i nevojshëm për të balancuar interesat e huajve me sigurinë dhe zhvillimin afatgjatë të sektorit bujqësor shqiptar, duke mbajtur kontrollin mbi pronësinë dhe përdorimin e tokës bujqësore në vend.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural do të përmbledhë të gjitha sugjerimet dhe komentet tuaja dhe do të japë arsyet për mënyrën se si ato janë reflektuar ose jo në projektakt. Kontributet tuaja do të konsiderohen përgjatë procesit të përmirësimit të mëtejshëm të projektaktit.

- Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimi publik do të zgjasë 20 ditë pune, nga data 14 maj 2026 deri më 11 qershor 2026.

Mund të merrni pjesë në procesin e konsultimeve publike duke dërguar komente/kontribute për projektaktin:

- Duke plotësuar formularin online të Regjistrin Elektronik për projektligjin, në adresën elektronike: <http://www.konsultimipublik.gov.al>:

- Me email duke dërguar propozimet/sugjerimet tuaja në adresën e koordinatorit të konsultimit publik për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Kjara Vogli , në adresën :Kjara.Vogli@bujqesia.gov.al

[Adra. Gjongecaj@bujqesia.gov.al](mailto:Adra.Gjongecaj@bujqesia.gov.al) .

Në vijim gjendet linku i publikimit për:

Projektligjin “*Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore tek personat fizike dhe juridike të huaj*”

<https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Institucioni/119>